



Me mbështetjen e:
Fondit Social



World Vision



QENDRA PËR SHËRBIME MBROJTËSE, FUQIZUESE DHE EMERGJENTE PËR FËMIJËN DHE FAMILJEN

Qendra për Shërbime Mbrojtëse, Fuqizuese dhe Emergjente për Fëmijën dhe Familjen është ngritur në Bashkinë e Durrësit, si një model shërbimesh në kuadër të Reformës Kombëtare për Shërbimet Sociale dhe Strategjisë së Mbrojtjes Sociale, me fokus kryesor mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, abuzimi, neglizhimi dhe shfrytëzimi. Shërbimet e ofruara në këtë qendër janë modeluar nga World Vision dhe Bashkia Durrës, me mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për të siguruar shërbimet e duhura për të gjithë fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe familjet e tyre, të ofruara si një paketë e plotë dhe efiçente, në përputhje me legjislacionin në fuqi si edhe me nevojat komplekse të tyre.

Kjo qendër ka për mision “Mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror si dhe të ofrojë shërbime që synojnë të ndikojnë pozitivisht në jetën e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve të tyre në situatë vulnerabel”.

Qendra krijon gjithashtu të gjitha mundësitë e nevojshme për t’ju ofruar fëmijëve, të rinjve dhe familjeve të tyre, mbështetje të vazhdueshme psiko-sociale, lehtësim të kushteve dhe situatës së tyre ekonomike si dhe alternativa të reja për integrim dhe fuqizim.

SHËRBIMI EMERGJENT

Shërbimi i Emergjencës është pjesë e integruar e shportës së shërbimeve të Qendrës, dhe ka në fokus mbrojtjen dhe strehimin e çdo fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe familjen e tij/saj, të ndodhur në situatë emergjente, që u kërcënon jetën dhe shëndetin. Specifikisht, ky shërbim ofron:

- (a) Strehim të sigurtë
- (b) Mbulimi i nevojave shëndetësore, mirëqenia e fëmijëve
- (c) Mbulimi i nevojave bazike ushqimore, higjieno-sanitare etj.
- (d) Manaxhimi i problemeve të shëndetit mendor të fëmijëve
- (e) Shërbime mbrojtëse (manaxhim rasti) dhe monitorim i rasteve në manaxhim
- (f) Sigurimi i materialeve të buta
- (g) Siguria për jetën

për fëmijët nga moshë 0-18 vjeç dhe prindërit me fëmijë, të cilët në rrethana të caktuara nuk janë të aftë të kujdesen për veten. Aktiviteti i këtij shërbimi realizohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit, për shërbimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, standardet për SHSES dhe praktikat pozitive. Është një shërbim që ofrohet gjatë dhe pas orarit zyrtar, 24 orë në ditë, gjatë 7 ditëve të javës.

Referuar përkufizimit në legjislacion shërbimi i emergjencës 72-orëshe ngrihet për:

- *viktima të dhunës në familje dhe*
- *fëmijët pa kujdes prindëror ose të dhunuar, fëmijë të rrugës, të shfrytëzuar, të abuzuar.*

Pika 8, VKM nr 518, dt.04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”

Të rriturit dhe fëmijët e larguar nga rreziku apo nga dhuna në familje kanë gjetur strehë në qendrën e emergjencës. Gjatë qëndrimit në qendrën e emergjencës përfituesit jo vetëm kanë shmangur rrezikun që i cënonte jetën, por gjithashtu kanë rritur reziliencën dhe përmirësuar aftësitë për të përballuar dëmtimet afatgjata në jetën psiko-sociale. Akomodimi në qendër ka zvogëluar nivelin e zakonshëm të stresit.

SHËRBIMI KOMUNITAR

Qendra për Shërbime Mbrojtëse, Fuqizuese dhe Emergjente për Fëmijën dhe Familjen ofron një paketë shërbimesh, në përputhje me nevojat e identifikuara në komunitet, si edhe me paketën e shërbimeve të parashikuara nga standardet e qendrave komunitare. Shërbimet kanë në fokus interesin më të lartë të fëmijëve, të të rinjve dhe familjeve të tyre në situatë vulnerabël dhe ofrohen në mënyre fleksible, në varësi të nevojave të individëve. Gjithashtu stimulojnë pjesëmarrjen dhe pavarësinë, dhe garantojnë ruajtjen e vlerave dhe personalitetit të individit dhe respektojnë parimin e universalitetit dhe barazinë.

Shërbime sociale për mbrojtjen e fëmijëve:

- **Shërbimi emergjent i mbrojtjes 72+** orë për fëmijët në nevojë për mbrojtje të menjëhershme
- Shërbim komunitar i integruar për mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet raportimit/referimit; vlerësimit të nevojave të fëmijës dhe familjes; vizitave në familje; menaxhimit dhe monitorimit të rasteve; adresimi i dhunës me bazë gjinore etj

Shërbime për fuqizimin e familjes:

- Programe për **fuqizimin e prindërve** nëpërmjet Prindërimit pozitiv dhe aktiviteteve me familjet.
- **Këshillim psikologjik** për prindërit dhe fëmijët (terapi grupi dhe/ose këshillim individual).
- **Shërbime mbështetëse për familjen** sipas nevojave imediate të identifikuara (paketa ushqimore dhe higjiëno-sanitare; mbështetje administrative, ligjore etj.)

Shërbime mbështetëse me qëllim zhvillimin komunitar:

- Programe **për fuqizimin dhe zhvillimin pozitiv** të fëmijëve dhe të rinjve. Programe për zhvillimin shpirtëror.
- Aktivitete komunitare **ndërgjegjësuse, zhvilluese dhe shërbime lëvizëse.**
- **Shërbime këshilluese, ndërmjetësuese** lidhur me punësimin, orientimin e karrierës dhe aspektet ligjore.
- Trajnime, workshops, takime me individë, prindër dhe anëtarë të komunitetit për rritjen e kapacitetit të tyre në fushat e mirëqënies sociale.